

Procedura që ndjekin funksionarët e lartë të MBZHR për të marrë vendime

Procedurat që ndjekin funksionarët e lartë për të marrë vendime janë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në mbështetje të ligjit Nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, nëpunësi më i lartë civil në ministri është Sekretari i Përgjithshëm, i cili raporton dhe jep llogari drejtpërdrejt te ministri. Funksionarë të lartë në ministri janë dhe anëtarët e trupit të lartë drejtues (TND), që në rastin e MBZHR janë Drejtorët e Drejtorive të Përgjithshme. Drejtorët e Përgjithshëm janë përgjegjës për përcaktimin e objektivave të drejtorive përbërese, përcaktimin e detyrave të drejtorive përbërese, për monitorimin e veprimtarisë së tyre dhe për sigurimin e koordinimit ndërmjet tyre dhe me njësi të tjera të ministrisë. Kompetencat dhe detyrat e funksionareve të lartë ushtrohen në përputhje me Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Ligjin Nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” dhe me të gjithë legjislacionin në fuqi për aq sa është i zbatueshëm. Lidhur me procedurat e zgjedhjes së tyre zbatohen dispozitat ligjore të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tij.

Funksionarët e lartë të MBZHR-së marrin vendime gjithashtu në përputhje me Rregulloren Nr. 2, date 4.12.2019 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”.



**Rregullore-per-para
ndalimin-e-konflikti**